



MISIONI SHQIPTAR

E Lumja Nënë Tereza

Blessed Mother Teresa Albanian Mission
739 Browns Line, Etobicoke, Ontario M8W 3V7
Tel. 416 503 4509 dhe 647 558 9382
www.misioninenetereza.com

Çdo të dielë në orën 12:30 Rruzarja dhe Mesha Shenjte

Jeta e pasosur

15 Mars 2015



Në atë kohë Jezusi i tha Nikodemit: “Sikurse Moisiu e lartësoi gjarprin në shkreti, po ashtu duhet të lartësohet edhe Biri i njeriut, që kushdo të besojë në të ta ketë jetën e pasosur. Vërtet, Hyji aq fort e deshi botën, sa që e dha një të vetmin Birin e vet, kështu që, secili që beson në të, të mos birret, por ta ketë jetën e pasosur. Në të vërtetë Hyji nuk e dërgoi Birin që ta dënojë botën, por që bota të shpëtojë nëpër të. Kush beson në të nuk dënohet, ndërsa kush nuk beson, ai është dënuar që tani, pse nuk besoi në Emrin e Njëlindurit, Birit të Hyjit. E gjykimi është ky: Drita erdhi në botë, por njerëzit më tepër deshën terrin se dritën, sepse veprat i kishin të këqija. Vërtet, kushdo që bën të keqen, e urren dritën dhe nuk del në dritë që të mos i zbulohen veprat e tija, kurse ai që e vë në zbatim të vërtetën, ai del në dritë që të dalë ballafaqë se veprat e tija u bënë siç thotë Hyji.” *Gjn 3, 14-21*

Mesha Shenjte....

Mesha kremtohet çdo të dielë në orën 12:30 te Kisha: Our Lady of the Miraculous Medal, **739 BROWN'S LINE, Etobicoke, M8W 3V7** (Browns Line & Evans Avenue) Phone (416) 255-2721. Kisha ndodhet menjehere mbrapa Slovenia Credit Union. Public transport: Brown's Line at Coules Court North Farside (15 m N) 123. Per me shume informacion shih faqen internet: www.ourladyofmm.com

Kalendari liturgjik...

18 Mars	Shen Cirili i Jeruzalemit
19 Mars	Shen Jozefi
20 Mars	Shen Niketa
21 Mars	Shen Justini

E marta e parë e Sh. Antonit (Shna Ndout)...



17 mars, e martë, **Mesha** per te marten e pare te Shna Ndout kremtohet **ne mbremje ne oren 7:30**

Udha e kryqit...

Te premten udha e kryqit kremtohet ne oren **7:45pm**.

Rregullat e Krezhmes... Në kohën e Krezhmes e Mërkurja e Përhime dhe të Premtet dhe të Shtunen e Madhe janë ditë njineset dhe abstinentet. **Njinesa** është marrja e një vakti kryesor t'vetëm n'ditë por Kisha Katolike lejon me marr pak ushqim n'mjes e n'darkë, përveç vaktit kryesor. **Abstinenca** është moskonsumimi i mishit apo i lëngjeve të mishit.

Kursi i gjuhes shqipe...

Çdo te diele ne oren 11 te ambientet e Kishes ne Browns Line vazhdon kursi i gjuhes shqipe per femijet (Ph. 416.503-4509)

Viti 2015, kalendar aktivitetesh...

Te shtunen **11 Prill** Easter Party; te dielen **9 Gusht** dita e piknikut; te dielen **6 Shtator** shtegtimi ne Midland Ontario; te shtunen **28 Nëntor** Party festa e Pavaresise; te shtunen **19 Dhjetor** Christmas Party.

Hakun e Kishes per vitin 2015

e ka dhene: **Kreshnik Kapaj**

Deri tani kane dhene:

Aleks	Coku
Arben	Toma
Edi	Linadi
Kreshnik	Kapaj
Leke	Kapllaj
Luk	Gjolaj
Marash	Martinaj
Martin	Pjetri
Nik	Biqi
Pjeter&Bep	Dreshaj
Prek	Lekaj
Preke	Gjonaj

Shpend	Pllumaj
Sokol	Ujka
Vladimir	Doda

Hakun e Kishes per vitin 2014: e kane dhene: **Kreshnik Kapaj, Franc Gjokaj.**

Zoti ua shperblefte ne te mira e ua shtofte!

Per Hakun e Klshes: Vini re...

Sikur eshte caktuar me vendim te shumices se anetareve **Haku Vjetor i Kishes** eshte 500 dollare dhe mund te jipet ne cash, check ose me credit card (shih faqen website misioninenetereza.com Donate Now for Blessed Mother Teresa Mission), **ne nje shume te vetme ose pjese pjese** gjate vitit. **Ata te cilet per arsye te ndryshme jane ne veshtiresi te kontaktojne drejperdrejt me famullitarin.**



Imzot Frano Gjini e martirët e 11 marsit 1948 vrrarë nga komunistët te Zalli i Kirit, në periferi të Shkodrës.

Që kujtimi i tyre të mos humbasë, por të bëhet shembull për breznitë e sotme e ato të ardhshme, është detyrë, ti kujtojmë shembujt e ndritur të Fesë e të Atdheut, sot ndërmjet tyre kujtojmë Imzot Frano Gjini, Atë Mati Prendushin e Atë Çiprjan Nikën, për të cilët tashmë ka filluar procesi dioqezan i beatifikimit. Ishte data 11 mars 1948 kur shkodranët e tmerruar dëgjuan përsëri të shtëna mitralozi te Zalli i Kirit. Flijoheshin këtë ditë për Krishtin e për Shqipërinë, përveç tre meshtarëve të lartpërmendur, edhe MonsinJOR Nikollë Deda bashkë me 12

besimtarë katolikë. **Imzot Frano Gjini:** Lindi në Shkodër në vitin 1886. Pasi kreu Kolegjin Saverian, vijoi studimet në Universitetin Urbanian në Romë. Menjëherë pas shugurimit u kthye në Atdhe dhe filloi shërbimin meshtarak si famullitar në Laç, Vlorë e Durrës. Më 1930 u emërua Ipeshkëv i Durrësit; dy vjet më vonë - Ipeshkëv i Abacisë së Mirditës me seli në Orosh; më 1945, pas largimit të delegatit apostolik, Imzot Nigris, nga Shqipëria, u emërua nga Selia e Shenjtë zëvendës-delegat apostolik. Ishte e para herë që një shqiptari i besohej një detyrë kaq e lartë. U arrestua në tetor 1946 me akuzën "agjent i Vatikanit" së cilës s'munguan t'i shtoheshin edhe akuza të tjera. Gjeti në qeli pjesën kryesore të sivëllezërve në meshtari. Por atij, si zëvendës-delegat, iu bë një trajtim i posaçëm: mbi trupin tij komunistët eksperimentuan të gjitha llojet e torturave, për ta bindur ta shkëpuste Kishën katolike nga Selia e Shenjtë. Qëndroi si shenjtë, derisa e pushkatuan më 11 mars 1948, duke ia këputur brohoritjen e fundit: "Rrnoftë Krishti mbret! Rrnoftë Shqipnia, edhe pa ne!". Selia e Tij nuk mbeti e zbrazët: pas Imzot Angelo Massafres, që tani i prin kryedioqezën metropolit të Shkodër-Pultit, Papa Gjon Pali II emëroi Imzot Kristofor Palmierin, rregulltar nga Bitonto (Bari), Ipeshkëv të dioqezës së Rrëshenit.

MonsinJOR Nikollë Deda: Lindi në Shkodër më 1892. Mësimet e para e të mesme i kreu në vendlindje, pranë Kolegjes Saveriane, të lartat- në Romë (Itali) e në Insbruk (Austri). U shugurua meshtar më 1917: Shërbeu në Qelës (Pukë) e Hajmel. Gjatë këtyre viteve, për shërbim shembullor meshtarak, iu dha titulli MonsinJOR. U arrestua në dhjetor 1946. E torturuan aq, sa kur i sollën në qeli një meshtar tjetër e nuk e njohu ai, me një humor tragjik, i tha: "Mos harro se dikur kam pasë kenë Dom Nikollë Deda". E gjykuan me akuzat e zakonshme në një gjyq-farsë. U dënua me vdekje dhe u ekzekutua më 11 mars 1948. **Atë Mati Prendushi:** Lindi në Shkodër më 1882. Mësimet e para e të mesme i kreu në Shkollën françeskane; të lartat, në Grac-Austri. Meshën e parë e çoi më 1904. Më 1911 ishte pranë Dedë Gjo'Lulit, në sa ky shpaloste në majë të Deçiqit flamurin shqiptar, larë me gjakun e bijve të vet. Jugosllavët e dënuan me vdekje si atdhetar i flakët, por më pas ia falën dënimin.

Shërbeu si famullitar në Bajzë, Gomsiqe, Tiranë e Shkodër, ku më 1943 qe provincial i fretënve. U arrestua nga komunistët më 1946 e u dënua rishtas me vdekje, këtë radhë nga bashatdhetarët e vet, i akuzuar si tradhtar i Atdheut. U pushkatua më 11 mars 1948 te Zalli i Kirit. **Atë Çiprjan Nika:** Lindi në Shkodër më 19 korrik 1900. Mësimet fillore e të mesme i kreu në Shkodër, të lartat - në Austri. U shugurua meshtar më 1924. Më 1938 qe provincial i fretërve; nga viti 1943 deri më 1936 - guardian i kuvendit françeskan në Shkodër. U arrestua më 1946 me akuzën e fshehjes së armëve në kishën françeskane, armë të vendosura aty nga vetë sigurimi, histori që është shtjelluar gjërë e gjatë nga Nikë Stajka, i pranishëm në këtë skenë kulmore të tragjedisë së Kuvendit të Gjuhadolit, në librin "Dera e Thyeme". U pushkatua pa gjyq më 11 mars 1948. Mbeti në kujtesën e atyre që e njohën, si meshtar shenjt, i përvuajtur, i kulturuar, atdhetar, muzikant e shkrimtar i talentuar: përmbushte kështu të gjitha kushtet, të cilat në Shqipërinë komuniste të çonin në pushkatim.



Pope Francis ✓@Pontifex

Beware of getting too comfortable! When we are comfortable, it's easy to forget other people.

Giovanni Selmani
Sales Representative
Direct: 647.500.3875

Office: 905.565.9200
Fax: 905.565.6677
E-Mail: gioselmani@hotmail.com
www.rightathomerealty.com

7045 Edwards Blvd., Suite 401
Mississauga, ON L5S 1X2



EAR JESUS,

help me to spread Thy fragrance everywhere I go. Flood my soul with Thy spirit and love. Penetrate and possess my whole being so utterly that all my life may only be a radiance of Thine. Shine through me and be so in me that every soul I come in contact with may feel Thy presence in my soul. Let them look up and see no longer me but only Jesus. Stay with me and then I shall begin to shine as you shine, so to shine as to be a light to others.

Pope Francis: "There is no middle way: Either we love or we are hypocrites and corrupt"

There are no compromises for Christians, for those who say they want to live according to the word of God. If we do not allow ourselves to be influenced by the mercy of the Lord and if we do not love our neighbour – like saints – then we are hypocrites who do more harm than good. This was Pope Francis' message at morning's mass in St. Martha's House.

Violeta Selmanaj, Broker
Tony Selmanaj, Sales Representative

Per Shitje, Blerje, Qera Shtëpi, Condo A Po
Biznese Lutemi Na Kontaktoni (Shume Vite
Eksperience Ne Toronto Dhe Rrethinat)

In House Mortgage Broker 25 Years
Experience Special Rates Through
Violeta and Tony Selmanaj For Fully
Qualified Applicants.
* Call for Details
Rates Subject To Change Without Notice and OAC.

Direct (416) 553-5044
Office: (905) 279-8300
Email: vselmanaj@trebnet.com

ROYAL LEPAGE Realty Centre, Brokerage®
2150 Hurontario Street Mississauga, ON L5B 1M8

* Independently Owned & Operated. Not intended to solicit properties already listed for sale or buyers under contract.

Rocco C Lofranco LL.B.
The Madison Centre
4950 Yonge Street Suite 600
Toronto ON M2N 6K1
416 223 8333
Toronto • Scarborough • Mississauga • Brampton

LOFRANCO CORRIERO
PERSONAL INJURY LAWYERS